



KARTAT BANKARE ...

Për kënaqësitë që të rezervon jeta!



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

PËRMBAJTJA

- Çfarë janë kartat bankare?..... 3
- Llojet e ndryshme të kartave bankare 3
- Çfarë janë ATM-të dhe POS-et? 6
- Avantazhet dhe disavantazhet e kartave bankare 6
- Shlyerja e pagesave 7
- Norma e interesit..... 8
- Komisionet 9
- Standardet e transparencës..... 9
- Mbrojtja e klientit..... 10
- Detyrimet e mbajtësit të kartës 11
- Si të përdorim kartat bankare në mënyrë të sigurt? 12
- Disa këshilla të thjeshta për një përdorim të sigurt të kartës për blerje nëpërmjet internetit..... 14



ÇFARË JANË KARTAT BANKARE?

Kartat bankare janë mjete elektronike pagese, të cilat në vendin tonë emetohen nga bankat tregtare. Ato, së bashku me shërbime të tjera elektronike, formojnë grupin e instrumenteve të pagesave me akses në distancë, të cilat bëjnë të mundur përdorimin e fondeve të llogarisë sonë bankare, zakonisht nëpërmjet numrit personal të identifikimit (PIN) dhe/ose mjeteve të tjera të identifikimit.

Kështu, funksionet që këto karta kryejnë janë krejt të ndryshme nga ato jobankare, të cilat kanë një karakter më promovues dhe shërbejnë për të nxitur blerjet në qendra tregtare apo dyqanet e emetuesit (rrjete dyqanesh etj.). Ato përgjithësisht shfrytëzojnë sistemin e grumbullimit të pikëve, përmes të cilave klienti mund të përfitojë ulje çmimesh apo produkte dhuratë.

LLOJET E NDRYSHME TË KARTAVE BANKARE

Kartat bankare janë krijuar për të na e bërë më të lehtë përdorimin e fondeve që mund të kemi në një llogari bankare. Nëpërmjet tyre ne mund të tërheqim cash, të kryejmë pagesa apo transferta, duke shmangur rreziqet e shumta që sjell lëvizja me shuma të mëdha paraje cash. Ato janë gjithashtu mjeti më i përshtatshëm e i pranueshëm për të kryer pagesa kur jemi në

udhëtim apo për të bërë blerje përmes internetit. Këto mjete janë thuajse të domosdoshme sa herë që duam të marrim me qira një makinë, të blejmë një biletë avioni, të rezervojmë një dhomë hoteli etj.



Megjithëse tregu ofron lloje të ndryshme kartash bankare, në vendin tonë ashtu si dhe në shumë vende të botës, më të përdorurat janë kartat e debitit dhe kartat e kreditit.

Kartat e debitit na mundësojnë të përdorim fondet e depozituara në llogarinë tonë rrjedhëse apo atë të kursimit. Transaksioni regjistrohet në llogarinë e klientit në mënyrë të menjëhershme. Për këtë arsye, është e rëndësishme që llogaria të përmbajë fonde të mjaftueshme për të përballuar blerjen apo tërheqjen e cash-it.

Teorikisht, nëpërmjet kartës mund të tërheqim të gjithë fondin që përmban llogaria personale. Megjithatë, për arsye sigurie, përgjithësisht, shuma që mund të tërheqim nga ATM-të apo që mund të paguajmë nëpërmjet POS-ve, ka një kufi ditor (limit) të paracaktuar nga banka.

Kartat e kreditit, në ndryshim nga ato të debitit, na mundësojnë të bëjmë blerje nga POS dhe interneti apo të tërheqim cash nga ATM/POS, brenda një kufiri të paracaktuar, pa pasur fonde në llogarinë tonë, por duke përdorur fondet që banka na ka vënë në dispozicion.

Pikërisht për këtë arsye, duhet të kemi gjithnjë parasysh që përdorimi i tyre mbart të gjitha detyrimet e formave të kredisë: ne do të jemi të detyruar ta kthejmë të gjithë shumën e përdorur së bashku me interesat e paracaktuara në kontratë. Pra, në krahasim me kartat e debitit, kartat e kreditit konsiderohen si një produkt kredie dhe si të tilla ato mbartin kosto më të larta. Në këto kushte, klienti duhet të jetë më i kujdesshëm në përzgjedhjen e këtij produkti bankar, si në lidhje me aftësitë e tij paguese, ashtu edhe me kushtet e ofruara nga ana e emetuesit të kartës.



Për kartat e kreditit, ashtu si dhe për ato të debitit, përdorimi i fondeve të disponueshme mund të bëhet i pjesshëm në harkun kohor të një dite. Kjo ndodh sepse, për arsye sigurie, banka emetuese vendos një kufi ditor ose mujor të parapërcaktuar.

Charge cards janë të ngjashme me kartat e kreditit, përveç faktit se shlyerja e kredisë bëhet e plotë dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Kartat cash janë karta e lejojnë mbajtësin vetëm të tërheqë para nga ARM-ja.

Kartat e parapaguara janë thjesht zëvendësuese elektronike e parasë cash dhe përdoruesit nuk i nevojitet të ketë një llogari bankare. Emetuesi pajis klientin me një kartë të parapaguar kundrejt një shume të caktuar. Nëpërmjet kësaj karte klienti mund të kryejë blerje dhe pagesa njësoj si të kishte para cash. Shumat e shpenzuara zbriten automatikisht nga fondi i kartës. Nëse mbajtësi dëshiron ta rimbushë kartën kur fondi i saj është shpenzuar, kjo mund të bëhet lehtësisht nëpërmjet një pagese të re të emetuesi.

“Për t’i ardhur në ndihmë klientëve gjatë shqyrtimit të produkteve bankare, si dhe për ta bërë më të lehtë krhasimin e përfitimit apo kostos së tyre, Banka e Shqipërisë ka krijuar një listë të dhënash mbi të gjitha produktet që ofron sot tregu bankar. Nëse dëshironi të dini më shumë për një produkt dhe mbi kushtet me të cilat banka të ndryshme e ofrojnë atë, mjafton të klikoni në:
http://www.bankofalbania.org/web/Informacion nga_bankat_6328_1.php.”



ÇFARË JANË ATM-TË DHE POS-ET?

Kartat bankare pranohen për përdorim në makineritë e posaçme, si: ATM-të apo терминалет POS.

ATM-ja (Automated Teller Machine) është një pajisje elektromekanike e cila bën të mundur tërheqjen ose depozitimin e parasë cash, pagesa të shërbimeve, transferim fondesh ndërmjet llogarive, nxjerrje llogarie etj. Ndërsa terminali POS (Point Of Sale) është pajisja që bën të mundur përdorimin e kartave bankare në një pikë shitjeje, për shembull në një dyqan apo restorant. Në të dyja rastet, pajisja printon një faturë, e cila përmban informacion mbi tërheqjen apo pagesën.

Kartat bankare mund të përdoren lehtësisht edhe për të bërë blerje të ndryshme nëpërmjet internetit duke hedhur në portalin e shitësit informacionin e kartës.

AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E KARTAVE BANKARE

Kartat bankare kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre, prandaj është e rëndësishme t'i njohim sa më mirë, në mënyrë që të dimë të përfitojmë nga përdorimi i tyre, pa rrezikuar.

AVANTAZHET

- Komoditet në kryerjen e pagesave (në supermarketet, dyqanet etj.) dhe tërheqjen e cash-it nga llogaria personale, në nxjerrjen e balancës, në shqyrtimin e lëvizjeve, në realizimin e transfertave dhe të çdo operacioni tjetër që mund të sigurojë ATM-ja dhe POS-i.
- Mënjanimi i rreziqeve që rrjedhin nga mbajtja e sasive të cash-it me vete.
- Kontroll më i mirë i shpenzimeve - nëse nuk kemi sasi cash-i me vete është vështirë që të tundohejmë nga blerje të nxituara.
- E drejta e përdorimit të fondeve të llogarisë tonë bankare edhe

jashtë kufijve të vendit tonë.

- Në veçanti karta e kreditit na mundëson të përdorim fondet e bankës duke blerë tani dhe paguar më vonë.
- Në rast humbjeje ose vjedhjeje të kartës, klienti ka mundësi që të bllokojë përdorimin e saj duke njoftuar bankën përmes shërbimit telefonik 24 orësh.

DISAVANTAZHET

- Komisione dhe shpenzime mirëmbajtjeje.
- Në rast se nuk tregojmë kujdesin e duhur për ruajtjen e të dhënave të kartës, ekziston mundësia që dikush të përvetësojë fondet në llogarinë tonë.
- Infrastrukturë e limituar në drejtim të shpërndarjes së ATM-ve dhe POS-eve në të gjithë vendin.
- Në veçanti për kartën e kreditit, në rast mos shlyerje në kohë të fondeve të shpenzuara, do të duhet të paguajmë interesa.
- Në veçanti karta e kreditit na krijon mundësinë të përdorim lehtësisht fonde të marra hua dhe nëse nuk tregohemi të kujdesshëm me shpenzimet, gjendja jonë financiare mund të përkeqësohet.



SHLYERJA E PAGESAVE

Në rastin e kartave të debitit, shlyerja e pagesës apo e tërheqjes në llogarinë rrjedhëse bëhet menjëherë. Për shembull, nëse kryejmë një blerje në një dyqan përmes kartës sonë të debitit, shuma mbahet menjëherë nga llogaria jonë rrjedhëse.

Ndryshe ndodh me kartat e kreditit. Ekzistojnë disa mënyra të ndryshme për të kryer shlyerjen të shumës që klienti ka përdorur nga fondi që banka i ka vënë në dispozicion. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që të informoheni mirë

mbi mënyrën e shlyerjes dhe të zgjidhni atë që paraqet më shumë interes për ju.

Dy mënyrat më të përdorura për të shlyer shumën që kemi shfrytëzuar nga fondi i një karte krediti janë: shlyerja me një pagesë të vetme dhe ajo me disa pagesa të shtyra në kohë.

Në rastin e parë, e gjithë shuma e përdorur nga klienti shlyhet e plotë në fund të periudhës së përcaktuar në kontratë. Për shembull, nëse periudha e parashikuar në kontratë është një muaj, atëherë shuma e parave të përdorura përgjatë kësaj periudhe kohore duhet t'i kthehet e plotë bankës në fund të muajit. Kur shlyerja kryhet në këtë mënyrë, përgjithësisht klienti nuk paguan interes.

Shlyerja përmes pagesave të shtyra në kohë mund të bëhet në shumë forma dhe në varësi të saj llogaritet edhe interesi. Klienti mund të zgjedhë që pagesa që do të shlyejë çdo muaj të llogaritet si përqindje ndaj shumës së përdorur ose të shlyejë çdo muaj një shumë fikse. Në përgjithësi, shuma që klienti i kthen bankës përmes pagesave mujore, i rivihet atij në dispozicion, duke iu shtuar përsëri limitit të papërdorur të kartës.



NORMA E INTERESIT

Bankat kërkojnë interes kur shlyerja e pagesës së shumës së përdorur nga fondi i një karte krediti shtyhet në kohë.

Përgjithësisht, për kartat e kreditit bankat përdorin interes fikse, pra norma shprehet si përqindje fikse ndaj shumës së përdorur (për shembull, 1,7 % e një shume x). Gjithashtu, duhet të keni parasysh se në përgjithësi norma e interesit e kartës së kreditit shprehet në terma vjetor.

Klienti paguan interesa që llogariten vetëm mbi shumën e përdorur prej tij dhe jo mbi të gjithë fondin që banka i ka vënë në dispozicion përmes kartës së kreditit.

Norma e interesit duhet të shënohet, jo vetëm në

kontratën që klienti firmos për t'u pajisur me kartë, por edhe në informacionin që banka duhet t'i japë klientit përpara se të nënshkruhet kontrata.

Për çdo ndryshim të normës së interesit ose të kostove të tjera, banka duhet të njoftojë paraprakisht klientin.

KOMISIONET

Ekzistojnë disa lloje komisionesh të lidhura me kartat e kreditit dhe të debitit. Komisionet që klienti do të paguajë për një kartë të caktuar bankare apo për veprimet që do të kryejë me të, duhet të pasqyrohen në kontratë dhe për çdo komision shtesë, përdoruesi i kartës duhet të njoftohet paraprakisht.

Në përgjithësi, bankat aplikojnë komisione sa herë që përdorim kartën për tërheqje cash-i nga терминаlet ATM, të cilat nuk i përkasin bankës që ka emetuar kartën, si brenda dhe jashtë vendit.

Komisione mbahen dhe në rastin e blerjeve në POS-e jashtë vendit dhe kur blejmë në internet. Klienti nuk paguan komision për blerjet nga POS-et brenda vendit edhe atëherë kur POS-i nuk i përket bankës emetuese të kartës.

Ekziston mundësia që bankat të mbajnë komisione edhe për tërheqje nga ATM-të e tyre. Në këtë rast, pranë ATM-së duhet të afishohet njoftimi, së bashku me shumën e komisionit.

STANDARDET E TRANSPARENCËS

Në mënyrë që vendimi për zgjedhjen e një produkti të jetë i matur dhe i shqyrtuar mirë, banka e pajis klientin me informacion mbi produktin për të cilin interesohet, përpara se ai të vendosi të nënshkruajë kontratën. Në këtë informacion duhet të pasqyrohen të gjitha kushtet e kontratës si dhe të drejtat dhe detyrimet që do të kenë të dyja palët pas nënshkrimit të saj.

“Banka informon konsumatorin për gjendjen e llogarisë së kartës së tij të kreditit, nëpërmjet një dokumenti të detajuar në fund të çdo cikli (që mund të jetë muaji kalendarik apo çdo periudhë tjetër e zgjedhur nga banka) gjatë të cilit klienti ka pasur veprime. Në këtë dokument pasqyrohet gjendja në fillim të periudhës në fjalë, të gjitha veprimet e ndodhura në llogari, norma e interesit, pagesat e komisioneve, si dhe gjendja në fund të periudhës.

”



Në mënyrë që përdoruesi i kartës bankare të jetë sa më i mbrojtur nga keqpërdorime të mundshme të fondeve në llogarinë e tij, Banka e Shqipërisë ka vendosur një sërë standardesh që duhet të respektohen si nga tregtarët që pranojnë kartën si mjet pagese ashtu edhe nga vetë përdoruesi. Kështu, nëse pranuesi i kartës ka dyshime për identitetin e mbajtësit të kartës mund të kërkojë paraqitjen e një dokumenti identifikimi.

Tregtari mund të mos e pranojë kryerjen e një pagese nëpërmjet kartës në rastet kur:

- Karta ka skaduar apo është e pavlefshme;
- Personi në emër të të cilit është emetuar karta ka njoftuar se karta është grabitur apo ka humbur;
- Firma në faturë nuk përputhet me firmën në kartë apo në mjetin e identifikimit;
- Mbajtësi i kartës nuk pranon të tregojë një dokument identifikimi;
- Vërehen pasaktësi në elementet e sigurisë së kartës apo kur tregtari dyshon që karta është false etj.

Në disa raste, si për shembull, kur është njoftuar se karta është vjedhur, kur firma në faturë nuk përputhet me firmën në kartë apo kur ndonjë element sigurie i kartës nuk është i saktë, tregtari ka të drejtë të sekuestrojë kartën.

Ai gjithashtu, duhet të pranojë pagesat e kryera nëpërmjet kartave, me të njëjtat kushte si për pagesat me *cash*, pa zbatuar komisione apo tarifa shtesë për përdorimin e këtij mjeti.



DETYRIMET E MBAJTËSIT TË KARTËS

Si mbajtës të një karte bankare, ne marrim përsipër përgjegjësinë e ruajtjes dhe përdorimit korrekt të saj, të numrit PIN dhe të dhënave të tjera me rëndësi.

Siç e dini, PIN-i është numri sekret që na mundëson të operojmë me kartën tonë. Por si mund të zgjedhim numrin PIN më të përshtatshëm?

Në momentin që tërheqim kartën nga banka ajo është e pajisur me një numër PIN të shënuar në një zarf të mbrojtur e që e njohim vetëm ne. Këtë PIN të zgjedhur në mënyrë rastësore mund të vendosim ta ndërrojmë me një numër tjetër. Në çdo rast, do të ishte mirë që të zgjedhim një numër të lehtë për t'u memorizuar, por jo të lehtë për t'u hamendësuar nga persona të tjerë. Për shembull, një zgjedhje e keqe do të ishte numri 1111, numri 1234 apo datëlindja jonë.

“Kujdes!

Është shumë e rëndësishme të mos ia japim askujt numrin PIN të kartës sonë dhe mbi të gjitha, të mos e mbajmë atë asnjëherë në të njëjtin vend ku mbajmë dhe kartën.

Në rast se humbasim kartën, kemi detyrimin të njoftojmë menjëherë bankën emetuese. Vetëm pas kësaj, do të jemi të lirë nga çdo përgjegjësi që lidhet me përdorim abuziv të saj. Nëse nuk tregohemi të kujdesshëm dhe nuk marrim menjëherë masa, do të jemi të detyruar të mbulojmë të gjitha pagesat që mund të bëhen nëpërmjet kartës tonë. Për këtë arsye është thelbësore që karta dhe të dhënat e saj të ruhen e të përdoren në mënyrë konfidenciale.



SI TË PËRDORIM KARTAT BANKARE NË MËNYRË TË SIGURT?

Karta është një “çelës” që mundëson akses në fondet e llogarisë sonë, prandaj është shumë e rëndësishme të dimë se si ta përdorim atë në mënyrën e duhur, duke shmangur kështu çdo rrezik.

Për t’u mbrojtur nga rreziku i humbjes apo përvetësimit të jashtëligjshëm të kartës duhet:

- të firmosim kartën me ta marrë ose të shkruajmë mbi të “kërkoni mjet identifikimi”;
- t’i vendosim dokumentet shoqëruese (kontratën, numrin PIN etj.) të kartës në vend sa më të sigurt dhe jo në të njëjtin vend me kartën;
- të memorizojmë numrin PIN, në mënyrë që të mos jemi të detyruar ta shënojmë diku;
- të përdorim me kujdes ATM-të. Gjatë shtypjes së numrit PIN, është mirë të përdorim dorën për të ruajtur tastierën nga vështrim i të tjerëve;



- edhe nëse nuk e përdorim shpesh kartën, duhet të kontrollojmë herë pas here gjendjen e saj;
- të mbajmë gjithnjë me vete numrin e telefonit të bankës që ka emetuar kartën, në mënyrë që të kemi mundësi ta kontaktojmë në raste emergjente.

Dikush mund të përdorë kartën tonë edhe pa e pasur atë fizikisht, mjafton që të ketë përvetësuar të dhënat e saj. Në shumë raste kjo do të ishte edhe më e rrezikshme se vetë përvetësimi i paligjshëm i kartës. Kjo për arsye se, meqenëse karta është ende në duart tona, mund të ndodhë që të mos e vëmë re menjëherë abuzimin që po i bëhet fondeve në llogarinë tonë.

Mënyra më e sigurt për të kryer një pagesë me kartë në një restorant apo supermarket do të ishte që të mos ia jepnim kartën shitëses apo kamerierit por pagesën në terminalin POS ta kryenim me dorën tonë.



DISA KËSHILLA TË THJESHTA PËR NJË PËRDORIM TË SIGURT TË KARTËS PËR BLERJE NËPËRMJET INTERNETIT

- *Bëni kujdes në dhënien e çdo informacioni apo të dhëne personale të kërkuara përmes internetit, sidomos kur ju bëhen oferta joshëse për punë apo okazione investimi dhe fitimi.*
- *Banka juaj mund t'ju kontaktojë edhe përmes e-mail-it apo sms-ve, por në asnjë moment nuk do t'ju kërkohet të dërgoni të dhënat dhe kodet tuaja përmes këtyre rrugëve.*
- *Mos shënoni asnjëherë në një e-mail numrin e kartës suaj apo numrin PIN.*
- *Asnjëherë mos klikoni mbi ndonjë adresë elektronike që ju është dërguar përmes e-mail-it (edhe nëse mund të ngjajë sikur dërguese është banka), por shkruani adresën e shërbimeve të internet banking drejtpërdrejt në shiritin e navigimit.*

Adresa elektronike mund të jetë false dhe të të lidhë me një faqe interneti false, shumë të ngjashme me origjinalen.



- *Kontrolloni që të mos ketë ndonjë parregullsi gjatë procedurave të aksesimit të internet banking, për shembull, në mënyrën se si të kërkohen të dhënat personale.*
- *Mundohuni të bëni blerje vetëm në faqe interneti të njohura për ju dhe që sigurojnë konfidencialitet të të dhënave tuaja.*
- *Kini parasysh që, për blerje përmes internetit nuk është asnjëherë e nevojshme të shënoni numrin tuaj PIN.*
- *Instaloni një program sigurie si anti-virus apo anti-spyware, dhe rinovoni gjithnjë ato dhe sistemin tuaj operativ.*
- *Tregoni kujdes në hapjen e e-mail-eve, dërguesin e të cilave nuk e njihni. Nëse keni dyshime, do të ishte më mirë t'i fshinit ato.*
- *Nëse procedura e identifikimit të përdoruesit jua lejon, ndërroni sa më shpesh fjalëkalimin.*



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

www.aab.al



www.bankofalbania.org

Botimi i kësaj broshure është pjesë e angazhimit të Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Bankës së Shqipërisë në një fushatë të gjerë në fushën e edukimit financiar. Një material më të zgjeruar mund të gjeni në faqet zyrtare të internetit të këtyre institucioneve.